

PLANI – MESIMOR PER
VITIN E I-re TE SHKOLLES
SE MAGJISTRATURES

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOLLA E MAGJISTRATURES
KESHILLI DREJTUES**

M I R A T O H E T

Kryetari

Thimjo KONDI

Hyrje

Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë është një institucion publik i pavarur i sistemit pasuniversitar, i cili një nga detyrat kryesore të tij ka trainimin fillestar të gjyqtarëve brenda një programi tre vjeçar.

Programi trevjeçar përfshin:

- **Vitin e parë-** që është me karakter teoriko-praktik, i ndarë në dy semestre me nga 16 javë secili. Semestri i parë fillon në 1 Tetor 2007 dhe mbaron me 1 Shkurt 2008, ndërsa semestri i dytë fillon në 4 Shkurt 2008 dhe mbaron në 31 Maj 2008, sesioni i provimeve është nga data 1 deri me 30 Qershor 2008. Totali i lëndëve që bëhen në këtë vit është 18, nga të cilat 10 lëndë kryesore janë vjetore dhe 8 lëndë semestrale. Totali i orëve gjatë vitit akademik është 1504 orë, të ndara 752 orë semestrin e parë, (47 orë/javë) dhe 752 orë për semestrin e dytë, (47 orë/javë).
- **Vitin e dytë-** të praktikës vëzhguese-pasive, ku kandidatët, për tre ditë në javë ndjekin nga afër punën që realizohet në gjykatat dhe prokuroritë ku ata kryejnë praktikën, si dhe dy ditët e tjera realizojnë konkluzionet e praktikës në shkollë, diskutojnë raste të ndryshme, përgatisin gjyqe imituese etj. Gjatë këtij viti, kandidatët përballojnë një ngarkesë mësimore prej 1464 orësh, nga të cilat 860 orë praktikë në organet e drejtësisë dhe 604 orë në auditorët e Shkollës. Drejtimi i praktikës së vitit të dytë, prezantimi i studentëve në gjykata e prokurori, organizimi i gjyqeve imituese, sesionet e debateve dhe kurset teorike bëhen nga dy pedagogë të brendshëm të shkollës. Shkolla në bashkëpunim me drejtuesit e gjykatave dhe prokurorive, ku magjistratët kryejnë praktikën, cakton gjyqtarët dhe prokurorët që do të ngarkohen me ndjekjen, organizimin, frekuentimin dhe

- mbarëvajtjen e punës së kandidatëve, si dhe vlerësimin me shkrim në përfundim të praktikës gjyqësore. Në programin e vitit të dytë kandidatët duhet të përgatisin plotësimin e një dosje civile ose penale, (që e zgjedhin vetë), duke kryer të gjitha veprimet procedurale dhe duke plotësuar të gjitha aktet deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit praktik. Gjatë vitit të dytë të shkolles kandidatët duhet të përgatisin edhe një temë civile ose penale nën udhëheqjen e një drejtuesi të aprovuar nga shkolla.
- **Vitin e tretë-** të praktikës aktive, ku kandidatët marrin një emërim paraprak nga Presidenti i Republikës dhe kryejnë stazhin si gjyqtarë apo prokurorë, fillimisht me çështje penale e civile të thjeshta, duke evoluar gradualisht drejt çështjeve më të vështira.

PLANI MESIMOR PER VITIN E I-TE TE SHKOLLES SE
MAGJISTRATURES
2007-2008

Shkolla e Magjistraturës është një vazhdim i arsimit juridik të fituar në Fakultetet e Drejtësisë. Ndonëse ajo nuk është pjesë e sistemit arsimor në Shqipëri, në përgatitjen e programeve dhe të planeve mësimore të saj mbështetet për analogji dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë.

Nr.	Lëndët	Gj.orë	Leksio n Orë	Seminar Orë	Provim Semes.	Sem.I 16 javë	Sem.II 16 javë
1.	E Drejta Civile(Pj.I-II)	192	128	64	2	4/2	4/2
2.	E Drejta Penale (Pj.I-II)	192	128	64	2	4/2	4/2
3.	Proçedura Civile	192	128	64	2	4/2	4/2
4.	Proçedura Penale	192	128	64	2	4/2	4/2
5.	E Drejta Tregëtare, Falimentimi ¹ , Konkurenca ²	84 16 12	50 8 6	34 8 6	2	2/1 2/1 2/1	2/2 2/2 2/2
6.	E Drejta Kushtetuese	64	32	32	2	1/1	1/1
7.	E Drejta e BE-së	64	32	32	2	1/1	1/1
8.	E Drejta Administrative	80	46	34	2	2/1	1/1
9.	E Drejta Familjare	96	64	32	2	2/1	2/1
10.	E Drejta e Punës & E Drejta e sig.shoqërore ³	64	32	32	2	1/1	1/1
11.	Të Drejtat e Njeriut	32	16	16	1	1/1	-
12.	Etika Profesionale	32	16	16	1	1/1	-
13.	Shkrim & Arsyetim Ligjor	32	16	16	1	1/1	-
14.	Menaxhimi i prokurisë dhe çështjeve të saj.	32	16	16	2	-	1/1
15.	E Drejta Ndërkomb. Private	32	16	16	1	1/1	-
16.	E Drejta Tatimore- Doganore	32	16	16	1	-	1/1
17.	E Drejta e Pronësisë Intelektuale	32	16	16	2	-	2
18.	Ndërmjetësimi, Arbitrazhi	32	16	16	2	-	2
	Totali orë	1504	910	594	-	47 ore	47 ore

¹ “Falimentimi” është i organizuar në formën e një mikrokursi që është vlerësuar si i rëndësishëm për shkak të rregullimit të tij me një ligj të vecantë të aprovuar rishtaz dhe që ndihmon gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm në zbatimin e procedurave të falimentimit të subjekteve tregtare. Meqënëse ngarkesa e këtij kursi është vetëm 16 orë, ai është atashuar pranë të Drejtës Tregtare, por duke pasur program dhe ekspertë të vecantë.

² Edhe për mikrokursin “Konkurenca” është i njëjti shpjegim si ai i bërë më sipër. Meqënëse ngarkesa e këtij kursi është vetëm 12 orë, ai është atashuar pranë të Drejtës Tregtare, por duke pasur program dhe ekspertë të vecantë.

³ Lënda “E Drejta e sigurimeve shoqërore” për shkak të orëve të pakta është bashkuar me lëndën “E drejta e punës”, por të dyja do të realizohen me program dhe ekspertë të vecantë.

Bazuar në ligjin Nr.7810, datë 06.04.1994 dhe në Udhëzimin Nr.22, datë 17.10.1997 "Për organizimin e kurseve të studimit në shkollat e larta", nxjerrë nga Ministri i Arsimit⁴, janë përcaktuar elemente të tillë si: ora e punës, efektet financiare të saj, koha e punës, kohëzgjatja e kurseve si edhe lloji i lëndëve.

Ora e punës në Shkollën e Magjistraturës	-	60 minuta
Ora e punës e programuar	-	45 minuta
Koha e pushimit	-	10 minuta
Dita e punës	-	8 orë
Fillon në orën 8.30 dhe mbaron në orën 16.30		
Dita e punës e programuar	-	8 ore
Koha e pushimit	-	1 ore ⁵
Java e punës në Shkollën e Magjistraturës	-	5 dite

Dita e shtunë dhe e dielë është pushim.

Sasia e orëve të punës së programuar për secilin nga kurset përcaktohet në funksion të :

- Natyrës dhe vështirësisë së kursit;
- Lloji i lëndës dhe rëndësia e saj për praktikën gjyqësore;
- Niveli i njohurive me të cilat vijnë kandidatët nga arsimimi paraprak juridik i tyre;
- Pajisjes së mësimdhënies me tekste, leksione të shkruara apo materiale të tjera,
- Detyrave të pavarura të ngarkuara paraprakisht kandidatëve.

Mbështetur në aktet e mësipërme në përgjithësi programi mësimor i secilës lëndë apo kurs përmban të paktën 32 orë⁶.

⁴ Bazuar në Udhëzimin e mësipërm, me Vendimin e Keshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës datë 26.07.2004, (i cili bazohet në V.K.M. Nr.694 datë 21.10.1996 si dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Nr.14 datë 19.10.1995), Per disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.7 datë 22.04.1999 të Këshillit Drejtues "Për shpërblimin e veprimtarisë drejtuese dhe mësimdhënese në Shkollën e Magjistratures", janë përcaktuar kriteret e përcaktimit të orës së mësimimit, mënyra e konvertimit të saj për efekt ngarkese, si dhe ekuivalenca e saj financiare për efekt pagese për pedagogët e jashtëm.

⁵ Pushimi organizohet me pushime 10 minuta midis seancave, si dhe me 30 minuta pushim dreke.

⁶ Kjo ngarkesë bie në 12 dhe 16 orë në disa mikrokurse të atashuara pranë lëndëve kryesore.

Mënyra e mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës është interaktive, e tillë që synon të paktën në:

1. trajtimin e elementeve teorike në formën e koncepteve dhe kurseve të reja, të ligjeve të reja apo të situatave të reja juridike duke shmangur përsëritjet nga njohuritë e marra në Fakultetin e Drejtësisë;
2. organizimin e debateve juridike lidhur me dispozita të diskutueshme juridike apo boshllëqe ligjore;
3. diskutim në çdo ore të rasteve të nxjerra nga praktika gjyqësore dhe zgjidhjen e tyre nga kandidatët duke u ndarë në grupe pune ose duke punuar me gjithë auditorin;
4. përgatitjen e gjyqeve imituese duke ndarë kandidatët në rolin e aktorëve të procesit si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ekspertë, e të tjera;
5. organizimin e takimeve dhe të vizitave pranë institucioneve të drejtësisë të të gjitha shkallëve si edhe institucioneve të lidhura me to.
6. ngarkimin e studentëve me përgatitjen e punimeve të pavarura lidhur me probleme të mprehta dhe aktuale të praktikës, në formë esse-sh ose tema të pavarura, duke u orientuar paraprakisht me literaturat e nevojshme për përgatitjen e temës. Këto punime mund të realizohen individualisht nga çdo kandidat ose edhe duke i ndarë ata në grupe pune me tre-katër persona.

Llojet e lëndëve që bëhen në Shkollën e Magjistraturës janë:

A. Lëndë vjetore të shtrira gjatë gjithë vitit akademik:

1. **E Drejta Civile,** është lëndë vjetore dhe e ndarë në dy semestra në 16 javë secila, është planifikuar të bëhet 6 orë në javë, dhe të jepet provim në fund të vitit.
2. **E Drejta Penale,** është lëndë vjetore dhe e ndarë në dy semestra në 16 javë secila, është planifikuar të bëhet 6 orë në javë, dhe të jepet provim në fund të vitit.
3. **Procedura Civile,** është lëndë vjetore dhe e ndarë në dy semestra në 16 javë secila, është planifikuar të bëhet 6 orë në javë, dhe të jepet provim në fund të vitit.
4. **Procedura Penale,** është lëndë vjetore dhe e ndarë në dy semestra në 16 javë secila, është planifikuar të bëhet 6 orë në javë, dhe të jepet provim në fund të vitit.
5. **E Drejta Tregtare,** është lëndë vjetore dhe e ndarë në dy semestra me 16 javë secili, është planifikuar të bëhet 3 orë në javë në semestrin e parë dhe 4 orë në javë në semestrin e dytë, dhe të jepet provim në fund të vitit.

6. **E Drejta Kushtetuese**, është lëndë vjetore dhe e ndarë në dy semestra në 16 javë secila, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë, dhe të jepet provim në fund të vitit.
7. **E drejta e BE-së**, është lëndë vjetore, e ndarë në dy semestra me 16 javë secili, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë dhe të jepet provim në fund të vitit.
8. **E drejta administrative**, është lëndë vjetore, e ndarë në dy semestra me 16 javë secili, është planifikuar të bëhet 3 orë në javë në semestrin e parë dhe 2 orë në javë në semestrin e dytë dhe të jepet provim në fund të vitit.
9. **E Drejta Familjare**, është lëndë vjetore, e ndarë në dy semestra me 16 javë secili, është planifikuar të bëhet 3 orë në javë dhe të jepet provim në fund të vitit.
10. **E Drejta e punës dhe e sigurimeve shoqerore** është lëndë vjetore, e ndarë në dy semestra me 16 javë secili, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë dhe të jepet provim në fund të semestrit.

B. Lëndët semestrale, në formën e kurseve:

11. **Të Drejtat e Njeriut**, është lëndë semestrale, e planifikuar të zhvillohet në semestrin e parë, të bëhet 2 orë në javë dhe të jepet provim në fund të semestrit të parë.
12. **Etika Profesionale**, është lëndë semestrale, e planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e parë dhe të jepet provim në fund të semestrit.
13. **Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor**, është lëndë semestrale, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e parë dhe të jepet provim në fund të semestrit.
14. **E Drejta Ndërkombëtare private**, është lëndë semestrale, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e parë dhe të jepet provim në fund të semestrit
15. **E Drejta Tatimore e Doganore**, është lëndë semestrale, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e dytë dhe të jepet provim në fund të semestrit.
16. **E Drejta e Pronësisë Intelektuale**, është lëndë semestrale, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e dytë dhe të jepet provim në fund të semestrit.

17. **Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi** është një lëndë e re, semestrare është planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e dytë dhe të jepet provim në fund të semestrit.
18. **Menaxhimi i prokurive dhe çështjeve të saj** është një lëndë e re, semestrare, është planifikuar të bëhet 2 orë në javë në semestrin e dytë dhe të jepet provim në fund të semestrit.

C. Lëndët në formën e mikrokurseve të atashuara pranë lëndëve kryesore:

a. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme është një kurs prej 12 orësh që është programuar të realizohet në semestrin e parë brenda ngarkesës së përgjithshme të Lëndës E Drejta Civile.

b. Falimentimi është një mikrokurs prej 16 orësh që është programuar të realizohet në semestrin e dytë brenda ngarkesës së përgjithshme të Lëndës E Drejta Tregtare.

c. Konkurrenca është një mikrokurs prej 16 orësh që është programuar të realizohet në semestrin e dytë brenda ngarkesës së përgjithshme të Lëndës E Drejta Tregtare.

PLANI MESIMOR PER VITIN
E II-TE TE SHKOLLES SE
MAGJISTRATURES

(Periudha e stazhit
paraprofesional)

1. Objektivat e përgjithshme të programit për magjistratët e vitit të II:

Gjatë vitit të dytë programi i Shkollës së Magjistraturës duhet të synojë që magjistratët:

- të forcojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teorike dhe praktike të marra në vitin e parë, drejt një praktike me karakter vëzhgues dhe pjesërisht aktiv;
- të shohin drejtpërdrejt pranë organeve të drejtësisë të të gjitha niveleve dhe shkallëve, si dhe institucioneve të lidhura me to, të tilla si: gjykatë, prokurori, Gjykatë Kushtetuese, Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyra avokatie e noterie, Zyra e gjendjes civile, e të tjera, mënyrën e punës dhe të funksionimit të tyre;
- të njihen me aktet kryesore procedurale në punën e gjyqtarit dhe prokurorit, mënyrën e përpilimit të tyre;
- të praktikojnë vetë hartimin e kateve të nevojshme në punën e tyre sipas profilit që ata kanë në rastet konkrete praktike si dhe në ato të improvizuara nga pedagogët përgjegjës;
- të plotësojnë formimin teorik të tyre me kurse të reja dhe me legjislacionin e ri të aprovuar gjatë periudhës që ata janë në studimet e vitit të dytë;
- të rrisin shprehitë dhe kapacitetet e nevojshme në shkrimin e materialeve teoriko-praktike, të tilla si, esse, artikuj, tema, skenare për gjyqe imituese e të tjera të ngjashme me to.

1.1 Qëllimi i specifikuar i programit mbështetur në profilin për gjyqtar dhe prokuror:

A- Për kandidatët për gjyqtarë:

Kandidati për gjyqtar do të realizojë programin që synon drejt dhënies e shprehive praktike lidhur me:

- Njohjen me procedurën e pranimit të kërkesë padive në gjykatë dhe provave që i bashkangjiten asaj, procedurën e hedhjes së shortit, rregjistrimin e padisë, si dhe përgatitjen e dosjes gjyqësore;
- Njohjen me elementët praktik të procedurës së gjykimit.
- Përgatitjen e kandidatit për drejtimin e seances gjyqësore, marrjen e provave në gjykim, marrjen e vendimeve të ndermjetme dhe dhënien e vendimit përfundimtar apo jo përfundimtar.
- Studimin e vendimeve gjyqësore, për të fituar shprehitë e përgatitjes së tij në mënyrë ligjore, llogjike dhe argumentuese.
- Përgatitjen e gjyqeve imituese në Shkollën e Magjistraturës nga kandidatët.

- Njohjen me gjykimet në të gjitha kolegjet, seksionet në shkallë të ndryshme të gjykimit;
- Njohjen me funksionimin e sektorëve ndihmës së gjykatës.
- Njohjen me procedurën e gjykimit në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë si dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këto gjykata.

B- Për kandidatët për prokurorë

Kandidati për prokuror do të realizojë programin që synon drejt dhënies së shprehive praktike lidhur me:

- Ndjekjen e procesit penal në hetim e në gjykim dhe krijimin e shprehive praktike për aktet procedurale që përpilohen nga prokurori;
- Njohjen me veprimtarinë praktike të policisë gjyqësore dhe veprimet kryesore që kryhen prej saj si dhe kontrolli i prokurorit mbi të;
- Studimin e dosjeve penale dhe përgatitja e dosjeve imituese nga kandidatët për prokuror;
- Pjesmarrjen në gjykime penale dhe njohjen e rolit të prokurorit në procesin gjyqësor.
- Përgatitjen e hetimeve dhe gjyqeve imituese në Shkollën e Magjistraturës me rastet e konstatuara në praktike.
- Njohjen me padinë civile në procesin penal dhe ushtrimi i kësaj të drejte në praktikë nga prokurori.
- Njohjen me rolin e prokurorit në përfaqësimin e çështjeve civile në Gjykatën e Lartë.
- Njohjen me gjykimet për masat e sigurimit dhe disponimet e tjera që lidhen më të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, (kontrolli i banesës, përgjimi, e të tjera).
- Njohjen e procedurës së ekzekutimit të vendimeve penale nga prokurori.
- Pjesmarrjen në gjykime në Gjykatën e Apelit, Prokurorinë e Apelit, Gjykatën e Krimeve të Rënda, Gjykatën dhe Prokurorinë e Apelit për Krimet e Rënda, si dhe Gjykatën e Lartë, për të njohur nga afër rolin e prokurorit përpara këtyre gjykatave.

2. Rrugët e realizimit të objektivave:

Rrugët e realizimit të objektivave të përgjithshme të parashtuar më sipër do të mbështeten në aktivitetet e mëposhtme:

- A- Vëzhgim praktik tre ditë në javë të punës dhe të akteve procedurale në gjykata/prokurori dhe atashim pranë një gjyqtari/prokurori me përvojë i cili do të ndjekë sipas programit të Shkollës mbarëvajtjen e praktikës së magjistratit. Përgatitja e projekt vendimeve apo projekt-aktesh të tjera proceduriale.

- B- Vizita të ndryshme për njohjen e procedurës së nxjerrjes së akteve administrative nga administrata shtetërore qendrore dhe lokale, njohjen e procedurës së ekzekutimit të vendimeve civile dhe titujve të tjerë ekzekutiv nga zyra e përmbarimit; njohjen e procedurës së marrjes së denoncimeve dhe veprimeve në kqyrjen e vendit të ngjarjes nga oficerët e policisë gjyqësore në komisaritet e policisë, etj⁷;
- C- Pjesëmarrje aktive dy ditë në javë në auditoret e Shkollës së Magjistraturës, për të diskutuar rreth problemeve, përshtypjeve, konkluzioneve praktike të hasura dhe të nxjerra gjatë praktikës pranë organeve të drejtësisë;
- D- Studimi i organizuar i dosjeve gjyqësore dhe trajnimi i tyre në seanca të veçanta seminaresh;
- E- Pjesëmarrje aktive për të marrë njohuritë teoriko-praktike në gjashtë kurse të reja me ngarkesë semestrale, që përfshin programi i vitit të II;
- F- Organizim i 10-15 gjyqeve imituese, ku magjistratët përgatisin vetë skenarët dhe ndarjen e roleve mbështetur në rastet praktike që ata vëzhgojnë konkretisht;
- G- Përgatitja e një gjyqi imitues i cili shfaqet publikisht me rastin e Ditës së Drejtësisë;
- H- Përgatitja e një dosjeje gjyqësore apo hetimi për një nga çështjet që ata ndjekin gjatë praktikës;
- I- Përgatitja e esreve dhe artikujve si dhe seleksionimi nga pedagogu përgjegjës i atyre punimeve që janë të përshtatshme për botim në Revistën "Jeta Juridike" të Shkollës apo në periodik të tjerë juridik.

3. Temë diplome

Përgatitja e një teme diplome e cila mbrohet në fund të vitit të II para një jurie të ngritur nga pedagogët e brendshëm të Shkollës, nën udhëheqjen e një profesionisti nga radhët e gjyqësorit/prokurorisë apo profesori universiteti dhe përballë një oponenti të seleksionuar nga Drejtoria e Shkollës.

Përgatitja e temës do të mbështetet në materialet arkivore të Gjykatës dhe të Prokurorisë si dhe literaturën e autorëve vendas dhe të huaj. Përzgjedhja e temave do të bëhet nga Drejtoria e Shkollës, pasi të jetë

⁷ Për më tepër hollësira lidhur me vizitat studimore në institucione e zyra shihni tableën përkatëse në pikën 5.3 të këtij materiali

marrë më parë edhe sugjerimi i studentëve. Tema do të dorëzohet në fund të muajit Prill 2008. Mbrojtja e temës bëhet para një jurie dhe ka vlerësim të veçantë.

4. Dosja e rastit praktik civil/penal:

Në programin e vitit të dytë kandidatët duhet të përgatisin plotësimin e një dosje civile ose penale, (që e zgjedhin vetë), duke kryer të gjitha veprimet procedurale dhe duke plotësuar të gjitha aktet deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit praktik. Kjo dosje merr vlerësim të veçantë, që do të zerë vendin e vet në vlerësimin e vitit të dytë të praktikës.

5. Personat Përgjegjës:

Përgjegjës për praktikën e vitit të dytë do të jenë dy pedagogë të cilët do të ndihmohen në punën e tyre nga një gjyqtar, (për studentët kandidatë për gjyqtarë) dhe një prokuror, (për studentët kandidatë për prokuror).

Kryetari i Gjykatës dhe Prokurori në rrethet ku do të zhvillohen praktikat do të jenë personat të cilët do të organizojnë, në bashkëpunim me pedagogun përgjegjës, mënyrën e realizimit të praktikës përfshirë qarkullimin në sektorë të ndryshëm të institucioneve, frekuentimin, kontaktet individuale me gjyqtarë e prokurorë etj.

6. Ngarkesa Mësimore Vjetore

Ngarkesa Mësimore Vjetore për magjistratët e vitit II është 1464 orë, nga të cilat 860 orë praktikë në organet e drejtësisë dhe 604 orë në auditor për zhvillimin e seminareve praktike, gjykimet imituese, e të tjera.

Zhvillimi i seminareve praktike në auditor do të përfshijë diskutimin e kazuseve të parapregatitura nga pedagogu përgjegjës apo të përgatitur nga studentët në bazë të çështjeve që ndjekin në praktikë, diskutimin e të gjithë akteve procedurale që duhet të përgatitin gjyqtarët dhe prokurorët. Ky diskutim do të organizohet mbi akte konkrete të përgatitura nga studentët. Po kështu do të organizohen gjyqe imituese në sallën – maket si dhe kurse të shkurtra teoriko – praktike.

Organizimi i praktikës do të bëhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për studentët kandidatë për gjyqtarë dhe pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për studentët kandidatë për prokurorë.

Ngarkesa mësimore javore do të jetë si më poshtë :

Praktika mësimore në Gjykatë e Prokurori do të zhvillohet të Martë, të Mërkurë e të Enjte nga ora 8⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰.

Diskutimi në auditoret e Shkollës do të jetë Ditën e Hënë e të Premte nga ora 8³⁰ – 16³⁰.

Viti akademik i ndarë në dy semestra:

Sem. I – rë 18 javë (1 Tetor 2007 - 15 Shkurt 2008)

Sem. II-të 18 javë (18 Shkurt 2008 – 30 Qershor 2008)

6. Programi i kurseve teorike dhe i aktiviteteve praktike:

Gjatë vitit të dytë të Shkollës së Magistraturës kurset teorike dhe aktivitetet praktike që do të zhvillohen me qëllim realizmin e programit të praktikës paraprofesionale si dhe afatet përkatëse do t'i gjeni të pasqyruara në tabelat e mëposhtme:

6.1 Plani i kurseve teoriko - praktike

Nr	Emërtimi i lëndës	Gjithsej orë	Sem.I-rë	Sem.II-të
1	Avokati i popullit	16	-	16
2	Rregjistrimi i pasurive	16	16	-
3	Kriminalistikë	16	16	-
4	Kriminalogji	16	16	-
5	Trafikimi i qenieve njerëzore	16	-	16
6	Përkatësia gjinore	16	-	16
7	E drejta e sigurimeve	16	16	-
8	Të drejtat e minoriteteve	8	8	-
9	E drejta e besimit	8	-	8
10	E drejta e mjedisit	16	-	16
11	Psikologji dhe komunikim	16	16	-
12	Funksionimi dhe Organizimi I Avokatisë.	8	-	8
13	Legjislacioni për prokurimet	16	-	16
14	Gjyqi imitues	420	202	218
	Shuma e orëve	604	290	314

6.2 Vizita për njohjen e veprimtarisë praktike të punës në sektorë të tjerë ndihmës të lidhur me punën e gjykatës dhe të prokurorisë.

INSTITUCIONI	AFATI
1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Tetor - Dhjetor 2007
2. Gjykata e Krimeve të Rënda Prokuroria e Krimeve të Rënda	Janar 2008
3. Gjykata e Apelit Tiranë Prokuroria e Apelit Tiranë	Shkurt 2008
4. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda	1 Mars - 15 Mars 2008
5. Njohja me punën në një Zyrë Avokatie	16 Mars – 31 Mars 2008
6. Avokati i Popullit Avokati i Shtetit	
7. Njohja e punës në një Qendër Ndërmjetësimi Njohja e punës në një Qendër Arbitrazhi.	
8. Vizita ditore: - Vizitë në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar - Vizitë në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme - Vizitë në një zyrë noteriale. - Vizitë në Bashkinë e Tiranës - Vizitë në komisariatit e policisë Tiranë - Zyra e Përmbarimit - Vizitë në një laborator kriminalistike - Vizitë në Burgun e Tiranës dhe burgjet e tjerë (të miturit, Institucionet e Paraburgimit etj.)	1 Prill – 15 Prill 2008
9. Gjykata e Lartë	16 Prill – 16 Maj 2008
10. Gjykata Kushtetuese	16 Maj – 30 Maj 2008

PLANI MESIMOR PER VITIN
E III-TE TE SHKOLLES SE
MAGJISTRATURES

(Periudha e stazhit
profesional)

Gjatë praktikës profesionale aktive të vitit të III të Shkollës së Magjistraturës kandidatët marrin një emërim paraprak nga Presidenti i Republikës dhe kryejnë stazhin si gjyqtarë apo prokurorë.

1. Objektivat e përgjithshme të programit për magjistratët e vitit të III:

- Të marrin një emërim provizor në gjykata dhe prokuroritë e përcaktuara nga Presidenti i Republikës;
- Të gjykojnë dhe hetojnë fillimisht me çështje penale e civile të thjeshta, duke evoluuar gradualisht drejt çështjeve më të vështira;
- Të konsolidojnë në praktikë njohuritë e marra në Shkollë;
- Të respektojnë normat e parimet e etikës profesionale, të paanshmërisë dhe të pavarësisë gjyqësore në dhënien e vendimeve;
- Të karakterizohen si profesionistë të ndershëm dhe të aftë nga ana profesionale;
- Të shkruajnë, të japin dhe të përpilojnë vendime gjyqësore dhe akte të tjera procedurale me gjuhë të saktë e të pasur juridike, me llogjikë dhe të bazuara në prova e në ligj.

2. Rrugët e realizimit të objektivave:

Rrugët e realizimit të objektivave të përgjithshme të parashtruar më sipër do të mbështeten në aktivitetet e mëposhtme:

Vëzhgim praktik dhe bashkëpunim i drejtuesve të gjykatave dhe prokurorive ku janë emëruar kandidatët me përfaqësuesit e Shkollës lidhur me mbarëvajtjen e punës së përditshme, etikën profesionale, etj;

Takime në Shkollë një herë në dy muaj: në nëntor, janar, mars dhe maj ku të diskutohen ecuria e punës, vështirësitë e hasura, çështje civile dhe penale, probleme teorike dhe pika juridike, etj;

Pjesëmarrje aktive të paktën tre herë në vit në seminarët e trainimit vazhdues të zgjedhura prej tyre në auditoret e Shkollës së Magjistraturës, për të diskutuar rreth problemeve, përshtypjeve, konkluzioneve praktike të hasura dhe të nxjerra gjatë praktikës pranë organeve të drejtësisë;

Përgatitja e një dosjeje me të gjitha vendimet gjyqësore apo aktet e hetimit për çështjet penale të prokurorisë të strukturuar sipas një modeli paraprak të aprovuar nga Drejtoria e Shkollës. Kjo dosje do të

shërbejë për vlerësimin përfundimtar të praktikës profesionale të vititi të III;

Përgatitja e esseve dhe artikujve, që janë të përshtatshëm për botim në Revistën "Jeta Juridike" të Shkollës apo në periodik të tjerë juridik.

3. Vlerësimi përfundimtar:

Vlerësimi përfundimtar bëhet në fund të vititi akademik 2007-2008. në muajin Qershor-Korrik bazuar në:

- Karakteristikën që vjen nga kryetari i gjykatës apo prokurori i rrethit ku kandidati ka kryer praktikën profesionale;
- Karakteristikën e bërë nga Këshilli Pedagogjik dhe Drejtoria e Shkollës;
- Vlerësimin me pikë të cilësisë së përpilimit të vendimeve gjyqësore dhe akteve të hetimit të dosjes gjyqësore, si dhe mënyrës së zgjidhjes së çështjeve, të argumentimit ligjor, të llogjikës, të shkrimit dhe arsytimit ligjor. Ky vlerësim i bëhet dosjes personale të çdo kandidati nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës.

Në vlerësimin përfundimtar të bërë nga Këshilli Pedagogjik, bazuar në të gjithë treguesit e sipërpërmendur bashkohen: Rezultatet e vitit të tretë, rezultatet e dy viteve të para dhe nga ky vlerësim përfundimtar Këshilli Pedagogjik shpall me Vendim edhe renditjen përfundimtare të kandidatëve për efekt emërimi. Dosjet e çdo kandidati në fund të të tre viteve me diplomat përkatëse, me gjithë rezultatet dhe karakteristikat e tyre i përcillen Këshillit të Lartë të Drejtësisë në fund të vitit të tretë të Shkollës me qëllim që të procedohet me emërimin përfundimtar të tyre mbështetur në renditjen e pikavarazhit të fituar prej tyre.

D R E J T O R E

ARIANA FULLANI